



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 689/prot
h

Gramsh më 02/02/2020

VENDIM

Nr. 21, datë 25/02/2020

“PËR

NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ETIKËS”

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës 25/02/2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe P/Vendimin “Për miratimin e Kodit Standart të Sjelljes për Bashkinë Gramsh, ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Etikës” të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në nenin 54 dhe nenin 64 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; Kodit i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë; Ligjit Nr.152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” (i ndryshuar); Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar); Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar); Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Kodit Standart të Sjelljes për Bashkinë Gramsh,

VENDOSI:

1. Të ngrihet Komisioni i Etikës si organi përgjegjës për zbatimin e Kodit Standart të Sjelljes për Bashkinë Gramsh;
2. Komisioni prej 5(pesë) anëtarësh do të ketë në përbërje:
 - Zv. kryetari i bashkisë
 - Drejtori i drejtorisë së burimeve njerëzore
 - Sekretar i përgjithshëm I Bashkisë
 - Këshillat i këshillit bashkiak
 - Këshillat i këshillit bashkiak
3. Komisioni do të funksionojë sipas dispozitave të Kodit Standart të Sjelljes për Bashkinë Gramsh;
4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Komisioni i Etikës si më sipër cituar;

Ky vendim hyn menjëherë

Sekretari i Keshillit

Endri Mema

Konceptoi: E. Mema

Pranoi: G. Lena

Miratoi: -/-



Kryetari i Këshillit

Greta LENA